



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**  
**Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë**  
**www.uni-gjilan.net tel: 0280390112**

**Vendimi. nr. 01 / 1703 / Dt. 02 / 11 /2020**

Menaxhmenti i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, në përputhje me mundësitë dhe kushtet reale të krijuara pas rritjes së rasteve pozitive me Corona Virus COVID-19 dhe bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/39 dt. 01.11.2020 merr

**V E N D I M**

1. Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/39 dt. 01.11.2020 për masat anti-Covid 19 dhe vendimin e Senatit nr. 01/1521 dt.13.10.2020, menaxhmenti i UKZ-së vendosë që ligjëratat të organizohen vetëm në formën on-line.
2. Ushtrimet praktike ose laboratorike, konsultimet, provimet kolokviumet etj, të mbahen në prani fizike duke respektuar rekomandimet e MSH-së. Ligjëratat dhe ushtrimet të mos mbahen të njëjtën ditë.
3. Dekanët e njësive akademike të përgatisin oraret mësimore sipas këtij vendimi.
4. Gratë shtatzëna dhe personat me sëmundje kronike, nuk kanë obligim të paraqiten në punë deri në ndryshimin e rrethanave të krijuara nga pandemia. Detyrat e punës nga personeli që i takon kategorisë së të punësuarve si në këtë paragraf, deri në një vendim /njoftim tjetër do të kryhen nga shtëpia.
5. Menaxhmenti i UKZ-së obligohet që të ndërmarrë të gjitha masat për pajisje me dezinfektues të sallave apo laboratorëve ku do të mbahen ushtrimet praktike/laboratorike.
6. Ky vendim zbatohet nga data 02.11.2020 dhe vlen deri në marrjen e një vendimi tjetër.

REKTORI

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

